

STATUTI

I

SHOQËRISË ME PËRGJEGJËSI TË KUFIZUAR

“EUROASIA CLEAN ENERGY” SH.P. K

Sot me dt.5/10/2021, duke u bazuar në Ligjin Nr.9901, datë 14.04.2008, "Për tregtarët dhe shoqëritë tregtare" i ndryshuar, si dhe në Ligjin Nr.9723, datë 03.05.2007 "Për Qendrën Kombëtare të Rregjistrimit" i ndryshuar, ne të nënshkruarit shprehim vullnetin tonë të lirë dhe të plotë, për të nënshkruar këtë statut me qëllim krijimin e shoqërisë "EUROASIA CLEAN ENERGY" SH.P.K si më poshtë vijon;

KREU I

Themelimi, Emri, Objekti, Kohëzgjatja, Selia

NENI 1

Data e Themelimit, Emri dhe Themeluesit

1.1 Sot me dt.5/10/2021, ne themeluesit, u krijua një shoqëri me përgjegjësi të kufizuar me emrin **“EUROASIA CLEAN ENERGY” SH.P.K**

1.2 Themelues i shoqërisë është :

EUROASIA GROUP SH.P. K, me NIPT: M0221200H, me seli ne adresen Rruga "Donika Kastrioti", Kotoni Center, Hyrja 2, Kati 3, Tiranë, Shqipëri, perfaqesuar nga Zj. Theodhora Koxhioni.

1.3 E cila ka vendosur krijimin e shoqërisë dhe miratimin e statutit të ri të shoqërisë në bazë të legjislacionit në fuqi të Republikës së Shqipërisë veçanërisht sipas Ligjit 9901 dt 14.04.2008, "Për Tregtarët dhe Shoqëritë Tregtare" i ndryshuar dhe si person juridik të zhvillojnë aktivitetin në përputhje me legjislacionin në fuqi dhe me normat e këtij statuti. Ky statut hyn në fuqi pas regjistrimit në Qendrën Kombëtare të Regjistrimit.


NENI 2

Objekti

Objekti kryesor i Shoqërisë do të përfshijë, por nuk do të kufizohet vetëm në veprimtaritë e mëposhtme:



1. Kompania ka për objekt kryerjen e aktiviteteve në fushën e të tregtisë dhe investimeve si dhe të në atë të konsultimit, promovimit dhe ndërmjetësit tregtar të biznesit në cdo fushë të zhvillimit të tij, në përputhje me legjislacionin shqiptar në fuqi.
2. Kompania do të jetë një operator tregtar dhe do të kryejë të gjitha aktivitetet e nevojshme në përputhje me legjislacionin shqiptar në fuqi për realizimin e këtij qëllimi në bashkëpunim me biznese rajonale evropiane dhe aziatike.
3. Tregtim me shumice dhe pakice, import-eksport i produkteve të prodhimit të energjisë termike diellore; shitjet e paneleve diellore, produktet e shfrytëzimit; shërbim teknologjik i gjenerimit të energjisë të shitjeve të energjisë diellore, të produkteve të shfrytëzimit termik diellor; shitjet e pajisjeve të prodhimit të energjisë termike diellore; shitjet e lëvizësit të ri kryesor të energjisë; kerkim dhe zhvillimi i teknologjisë të burimeve të riciklueshme, shërbimet teknike, zhvillimi teknik, konsultimi teknik, transferimi teknik, promovimi teknik, shërbimi i menaxhimit inxhinierik, shitjet e pajisjeve elektrike mekanike, shërbim i standardizuar, tregtimi komercial, prodhimi i pajisjeve elektronike të vecanta ,import -eksport , prodhim i makinave elektrike dhe i pjeseve të tyre; import -eksport , montim e dhenie me qira e stacioneve të furnizimit me energji elektrike. Dhenia me qira e pajisjeve të prodhimit të energjisë PV: prodhimin e pajisjeve dhe përbërësve fotovoltaike, riparimi i pajisjeve të përgjithshme prodhuese. Prodhimi i komponentëve elektronikë të energjisë: shitja e materialeve sintetike; prodhimi i pajisjeve të specializuara të makinave elektrike; prodhimi i lëvizësit të ri kryesor të energjisë; prodhimi i pajisjeve speciale për pajisjet gjysmëpërçuese; prodhimi i materialeve speciale elektronike; ndërtimin e centraleve prodhuese për prodhimin e energjisë së rinovueshme; projekte elektromekanike dhe gjeotermale; në çfarëdo formë projektimin, ndërtimin, instalimin dhe tregtimin e sistemeve të energjisë së rinovueshme, parqeve diellore, turbinave të erës dhe sistemeve hidroelektrike të shfrytëzuara për vete ose për të tjerët, marketingun dhe prodhimin e sistemeve elektronike, komponentët e sistemet periferike për burimet e rinovueshme, mbështetje që përfshin mirëmbajtjen dhe riparimin e produkteve dhe instalimeve. Ndërmjetësim me komision për blerjen, shitjen, prodhimin, instalimin e sistemeve të burimeve të energjisë së rinovueshme, parqeve diellore, turbinave me erë dhe sistemeve hidroelektrike të shfrytëzuara për vete ose për të tjerët, marketingun dhe prodhimin e sistemeve elektronike, komponentët e sistemet periferike për burimet e rinovueshme. Shërbimet e komisionit financiar të ndërmjetësit për blerjen, shitjen, prodhimin, instalimin e sistemeve të ripërtërishme të energjisë, fermave diellore, turbinave të erës dhe sistemeve hidroelektrike të shfrytëzuara për vete ose për llogari të palëve të treta, marketingun dhe prodhimin e sistemeve elektronike, komponentët e sistemet periferike për burimet e rinovueshme. Importi, eksporti dhe tregtia e produkteve të ngrohjes, kondicioner, panele diellore të ujit, instalimin dhe mirëmbajtjen e mallrave dhe produkteve të shoqërisë përmes serviseve teknike.



4. Shoqëria mund të investojë me pjesëmarrje në kuota dhe mund të kryejë bashkëpunim me palë të treta vendase ose të huaja në mënyrë që të ofrojë shërbimet, tregtimin e produkteve, të drejtat ekskluzive të shitjes dhe tregtimin të produkteve dhe "Brand"-eve aziatike, në tregun rajonal dhe evropian.

6. Të kryejë cdo transaksion në lidhje me pasuritë e luajtshme apo ato të paluajtshme si dhe cdo aktivitet tregtar, të vendosë pengje ose barrë hipotekore, aktivitete këto të konsideruara të dobishme apo te nevojshme për të arritur qëllimet e shoqërisë.

7. Për të gjitha aktivitetet që kërkojnë liçensa të veçanta shoqëria do të angazhohet për të plotësuar kërkesat ligjore të posaçme sipas legjislacionit në fuqi.

8. Për më tepër Shoqëria mund të kryejë cdo aktivitet tjetër i cili nuk është i ndaluar nga ligji në fuqi, që sjell përfitime dhe është në interes të Shoqërisë

NENI 3

Kohëzgjatja

3.1 Kohëzgjatja e shoqërisë do të jetë me një afat të pacaktuar , duke filluar nga data e regjistrimit në Qendrën Kombëtare të Regjistrimit, me përjashtim të rastit të mbarimit të saj sipas kushteve të parashikuara në ligj ose me vendim të ortakëve të shoqërisë.

NENI 4

Selia

4.1 Selia e shoqërisë ndodhet në adresën: **Rruga "Donika Kastrioti", Kotoni Center, Hyrja 2, Kati 3, Tiranë, Shqipëri.**

4.2 Adresa e shoqërisë për qëllime komunikimi elektronik është si vijon:

Email : ik@euroasiaip.com


KREU II

Neni 5

Kapitali themeltar

5.1 Kapitali themeltar fillestar i shoqërisë është, 2000000(Lekë (*sipas ligjit kapitali nuk mund të jetë më i vogël se 100 lekë*). Pjesëmarrja e themeluesve në kapitalin e shoqërisë është në përputhje me kontributet e tyre të mëposhtme:

1. Ortaku themelues EUROASIA GROUP SH.P.K : Zotërues i 1 (një) kuotë me vlerë të përgjithshme 2 000 000 që përben 100% të kapitalit themeltar të shoqërisë.



5.2 Kontributi i ortakëve mund të jetë në para ose në natyrë (pasuri të luajtshme/të paluajtshme apo të drejta)

NENI 6

Zmadhimi dhe zvogëlimi i kapitalit

6.1 Kapitali i shoqërise mund të zmadhohet nëpërmjet nënshkrimeve të pjesëve të kapitalit themeltar për kontributet në para dhe me anë të kontributeve në natyrë, nëpërmjet emërimit të një eksperti të autorizuar dhe licensuar për keto kontribute me vendim asambleje të shoqërisë sipas kërkesës së administratorit.

6.2 Në asnjë rast shumica nuk mund të detyrojë një ortak për të rritur angazhimin e tij në kapitalin themeltar të shoqërisë.

6.3 Zvogëlimi i kapitalit lejohet nga asambleja e ortakëve, e cila merr vendim në të njëjtat kushte që kërkohen për ndryshimin e statutit, vendimet merrën me 2/3 e kuotave pjesëmarrëse

6.4 Në të gjitha rastet zvogëlimi i prek ortakët në të njëjtën masë ndaj pjesëve të kapitalit që përfaqësojnë.

Neni 7

Transferimi i kapitalit

7.1 Kuotat e kapitalit të një shoqërie me përgjegjësi të kufizuar e të drejtat që rrjedhin prej tyre mund të fitohen apo kalohen nëpërmjet:


- a) kontributit në kapitalin e shoqërisë;
- b) shitblerjes;
- c) trashëgimisë;
- ç) dhurimit;
- d) çdo mënyre tjetër të parashikuar me ligj.

7.2 Pjesët e kapitalit themeltar janë lirisht të transferueshme ndërmjet ortakëve, ndërsa për persona të tjerë jashtë shoqërisë do të funksionojë e drejta e parablerjes, për sa nuk parashikohet ndryshe në statut.

7.3 Pjesët e kapitalit themeltar janë lirisht të transferueshme me rrugë trashëgimie.

KREU III

ORGANET VENDIMMARRESE DHE DREJTUESE




Neni 8 Organi Vendimmarrës

- 8.1 Asambleja e Ortakëve është organi i vetëm vendimmarrës i shoqërisë.
- 8.2 Asambleja e Ortakëve është organi i vetëm vendimmarrës i shoqërisë që miraton cdo ndryshim të statutit sipas modaliteteve të përcaktuara në ligj.
- 8.3 Asambleja e përgjithshme e ortakeve është përgjegjëse për marrjen e vendimeve për shoqërinë për çështjet e mëposhtme:
- a) përcaktimin e politikave tregtare të shoqërisë;
 - b) ndryshimet e statutit;
 - c) emërimin e shkarkimin e administratorëve;
 - ç) emërimin e shkarkimin i likuiduesve dhe të ekspertëve kontabël të autorizuar;
 - d) përcaktimin e shpërblimeve për personat e përmendur në shkronjat “c” dhe “ç” të kësaj pike;
 - dh) mbikëqyrjen e zbatimit të politikave tregtare nga administratorët, përfshirë përgatitjen e pasqyrave financiare vjetore dhe të raporteve të ecurisë së veprimtarisë;
 - e) miratimin e pasqyrave financiare vjetore dhe të raporteve të ecurisë së veprimtarisë;
 - ë) zmadhimin dhe zvogëlimin e kapitalit;
 - f) pjesëtimin e kuotave dhe anulimin e tyre;
 - g) përfaqësimin e shoqërisë në gjykatë dhe në procedimet e tjera ndaj administratorëve;
 - gj) riorganizimin dhe prishjen e shoqërisë;
 - h) miratimin e rregullave procedurale të mbledhjeve të asamblesë;
 - i) çështje të tjera të parashikuara nga ligji apo statuti.
- 8.4 Ortaku mund të përfaqësohet në asamblenë e përgjithshme, në bazë të një autorizimi nga një ortak tjetër apo nga një person i tretë.

Neni 9 Mënyra e thirrjes së mbledhjes së Asamblese së Përgjithshme

- 9.1 Asambleja e përgjithshme thirret nëpërmjet një njoftimi me shkresë ose, nëse parashikohet nga statuti, me njoftim nëpërmjet postës elektronike, platformave online etj. Njoftimi me shkresë apo me mesazh elektronik duhet të përmbajë vendin, datën, orën e mbledhjes dhe rendin e ditës e t’u dërgohet të gjithë ortakëve, jo më vonë se 7 ditë përpara datës së parashikuar për mbledhjen e asamblesë.



9.2 Kur asambleja e përgjithshme nuk është thirrur sipas pikës 1 të këtij neni, ajo mund të marrë vendime të vlefshme vetëm nëse të gjithë ortakët janë dakord, për të marrë vendime, pavarësisht parregullsisë.

Neni 10 Kuorumi

10.1 Në rastin e marrjes së vendimeve, që kërkojnë një shumicë të zakonshme, asambleja e përgjithshme mund të marrë vendime të vlefshme vetëm nëse marrin pjesë ortakët me të drejtë vote, që zotërojnë më shumë se 30 për qind të kuotave.

10.2 Në rastin kur asambleja e përgjithshme duhet të vendosë për çështje, të cilat kërkojnë shumicë të kualifikuar sipas nenit 87 të ligjit “ Për Tregtarët dhe Shoqëritë Tregtare “, ajo mund të marrë vendime të vlefshme vetëm, nëse ortakët që zotërojnë më shumë se gjysmën e numrit total të votave, janë të pranishëm personalisht, votojnë me shkresë, apo mjete elektronike, sipas parashikimeve të pikës 3 të nenit 88 të këtij ligji.

10.3 Nëse asambleja e përgjithshme nuk mund të mbledhet për shkak të mungesës së kuorumit të përmendur më lart, asambleja mbledhet përsëri jo më vonë se 30 ditë, me të njëjtin rend dite.


Neni 11 Marrja e vendimeve

11.1 Asambleja e përgjithshme vendos me tri të katërtat e votave të zotëruesve të kapitalit, të ortakëve pjesëmarrës, për ndryshimin e statutit, zmadhimin ose zvogëlimin e kapitalit të regjistruar, shpërndarjen e fitimeve, riorganizimin dhe prishjen e shoqërisë.

11.2 Asambleja e përgjithshme vendos me shumicën e votave të ortakëve pjesëmarrës, për çështje të tjera si :

- a) përcaktimi i politikave tregtare të shoqërisë;
- b) emërimin dhe shkarkimin e administratorëve;
- c) emërimin e shkarkimin e likuiduesve dhe të ekspertëve kontabël të autorizuar;
- ç) përcaktimin e shpërblimeve
- d) mbikëqyrjen e zbatimit të politikave tregtare nga administratorët, përfshirë përgatitjen e pasqyrave financiare vjetore dhe të raporteve të ecurisë së veprimtarisë;
- e) përfaqësimin e shoqërisë në gjykatë dhe në procedimet e tjera ndaj administratorëve;
- f) miratimin e rregullave procedurale të mbledhjeve të asamblesë;

Cdo ndryshim statuti duhet të depozitohet pranë QKB për të pasqyruar ndryshimet në skedën e shoqërisë.



Neni 12

Përfashtimi nga e drejta e votës

12.1 Ortaku nuk mund të ushtrojë të drejtën e votës nëse asambleja e përgjithshme merr vendim për:

- a) vlerësimin e veprimtarisë së tij;
- b) shuarjen e ndonjë detyrimi në ngarkim të tij;
- c) ngritjen e një padie ndaj tij nga shoqëria;
- ç) dhënien ose jo të përfitimeve të reja.

12.1 Kur ortaku përfaqësohet nga një përfaqësues i autorizuar, i autorizuari vlerësohet të jetë në të njëjtin konflikt interesi, ashtu si dhe ortaku, të cilin përfaqëson.

Neni 13

Administrimi

13.1 Asambleja e përgjithshme emëron një persona fizikë si administratorë të shoqërisë.

13.2 Afati i emërimit, 2 muaj , me të drejtë ripërtëritjeje. Emërimi i administratorit prodhon efekte pas regjistrimit në Qendrën Kombëtare të Regjistrimit.

13.3 Administrator I perkohshem emerohet

Z. Endrit Istrefi, I biri i Eduartit, me shtetesi shqiptare, lindur ne Tirane, me 30/05/1998, I pajisur me pasaporte me nr.BJ5356564, leshuar me 06/01/2017, me date skadimi 05/01/2027 , me numer personal J80530070B, me zotesi te plote per te vepruar.


a. Specimetri Firmës

Neni 14

Kompetencat e Administratorëve

14.1 Administratorët kanë të drejtë e detyrohen të:

- a) kryejnë të gjitha veprimet e administrimit të veprimtarisë tregtare të shoqërisë, duke zbatuar politikat tregtare, të vendosura nga asambleja e përgjithshme;
- b) përfaqësojnë shoqërinë tregtare;
- c) kujdesen për mbajtjen e saktë e të rregullt të dokumenteve dhe të librave kontabël të shoqërisë;



ç) përgatisin dhe nënshkruajnë bilancin vjetor, bilancin e konsoliduar dhe raportin e ecurisë së veprimtarisë dhe, së bashku me propozimet për shpërndarjen e fitimeve, i paraqesin këto dokumente përpara asamblesë së përgjithshme për miratim;

d) krijon një sistem paralajmërimi në kohën e duhur për rrethanat, që kërcënojnë mbarëvajtjen e veprimtarisë dhe ekzistencën e shoqërisë;

dh) kryejnë regjistrimet dhe dërgojnë të dhënat e detyrueshme të shoqërisë, siç parashikohet në ligjin për Qendrën Kombëtare të Regjistrimit;

e) raportojnë përpara asamblesë së përgjithshme në lidhje me zbatimin e politikave tregtare dhe me realizimin e veprimeve të posaçme me rëndësi të veçantë për veprimtarinë e shoqërisë tregtare;

ë) kryejnë detyra të tjera të përcaktuara në ligj dhe në statut.

14.2 Administratoret janë të detyruar të therrasin Asamblenë e Përgjithëshme, në rastet kur:

- sipas bilancit vjetor apo raporteve të ndërmjetme financiare, rezulton ose ekziston rreziku që aktivet e shoqërisë nuk i mbulojnë detyrimet e kërkueshme brenda 3 muajve në vazhdim.

- shoqëria propozon të shesë apo të disponojë në mënyrë tjetër brenda, të cilat kanë një vlerë më të lartë se 5 për qind të asetëve të shoqërisë, që rezulton në pasqyrat e fundit financiare të certifikuar.

- shoqëria, brenda 2 viteve të para pas regjistrimit të saj, propozon të blejë nga një ortak pasuri, që kanë vlerë më të lartë se 5 për qind të asetëve të shoqërisë, që rezulton në pasqyrat e fundit financiare të certifikuar.

14.3 Nëse asambleja e përgjithshme emëron më shumë se një administrator, ata e administrojnë bashkërisht shoqërinë.

14.4 Asambleja e përgjithshme mund të shkarkojë administratorin në çdo kohë me shumicë të zakonshme. Paditë, që lidhen me shpërblimin e administratorit, në bazë të marrëdhënieve kontraktore me shoqërinë, rregullohen sipas dispozitave ligjore në fuqi.

Neni 15

Përgjegjësitë e Administratorit

15.1 Administratori është përgjegjës individualisht, ndaj shoqërisë ose ndaj të tretëve, për shkelje të ligjeve, për shkelje të statutit, apo për faje të kryera gjatë administrimit të shoqërisë.

15.2 Pasojat e marrëveshjeve të pamiratuara nga asambleja që i sjellin dëm shoqërisë, i ngarkohen administratorit dhe ortakut që ka bërë marrëveshjen, për të përballuar në mënyrë individuale ose solidarisht sipas rastit pasojat përkatëse.

15.3 Përveç sa është parashikuar në dispozitat e përgjithshme të detyrimit të besnikërisë, sipas neneve 14, 15, 17 e 18 të ligjit "Per Tregtaret dhe Shoqërite Tregtare", administratori detyrohet:

a) të kryejë detyrat e tij të përcaktuara në ligj dhe në statut në mirëbesim e në interesin më të mirë të shoqërisë në tërësi, duke i kushtuar vëmendje të veçantë ndikimit të veprimtarisë së shoqërisë në mjedis;

b) të ushtrojë kompetencat që i njihen në ligj dhe në statut vetëm për arritjen e qëllimeve të përcaktuara në këto dispozita;

c) të vlerësojë me përgjegjësi çështjet, për të cilat merret vendim;

ç) të parandalojë dhe mënjanojë rastet e konfliktit, prezent apo të mundshëm, të interesave personalë me ata të shoqërisë;

d) të ushtrojë detyrat e tij me profesionalizmin dhe kujdesin e nevojshëm.

15.4 Administratori, gjatë kryerjes së detyrave të tij, përgjigjen ndaj shoqërisë për çdo veprim ose mosveprim, që lidhet në mënyrë të arsyeshme me qëllimet e shoqërisë tregtare, me përjashtim të rasteve kur, në bazë të hetimit dhe vlerësimit të informacioneve përkatëse, veprimi ose mosveprimi është kryer në mirëbesim.

15.5 Nëse administratori vepron në kundërshtim me detyrat dhe shkel standardet profesionale, sipas pikave 1 e 2 të këtij neni, është i detyruar t'i dëmshpërblejë shoqërisë dëmet, që rrjedhin nga kryerja e shkeljes, si dhe t'i kalojë çdo fitim personal që ata apo personat e lidhur me ta kanë realizuar nga këto veprime të parregullta. Administratori ka barrën e provës për të vërtetuar kryerjen e detyrave të tyre në mënyrë të rregullt e sipas standardeve të kërkuara. Kur shkelja është kryer nga më shumë se një administrator, ata përgjigjen ndaj shoqërisë në mënyrë solidare.

15.6 Në mënyrë të veçantë, por pa u kufizuar në to, administratori është i detyruar t'i dëmshpërblejë shoqërisë dëmet e shkaktuara, nëse, në kundërshtim me dispozitat e ligjit ,, Per Tregtaret dhe Shoqërite Tregtare , kryen veprimet e mëposhtme:

a) u kthen ortakëve kontributet;

b) u paguan ortakëve interesa apo dividendë;

c) u shpërndan aktivet shoqërisë;

ç) lejon që shoqëria të vazhdojë veprimtarinë tregtare, kur, në bazë të gjendjes financiare, duhej të parashikohej që shoqëria nuk do të kishte aftësi paguese për të shlyer detyrimet;

d) jep kredi.

15.7 Përveç padisë për shlyerjen e dëmit që i ngarkohet personalisht administratorit, ortakët individualisht ose se bashku, kanë të drejtë të ngrenë padi penale kundër administratorit

15.8 Paditësit kanë të drejtë të ndjekin në rrugë ligjore shlyerjen e plotë të dëmit që i është shkaktuar shoqërisë, përfshirë edhe dëmshpërblimin financiar, nëse është e nevojshme. Asnjë vendim i asamblesë nuk mund të ndalojë ngritjen e kërkesë padisë kundër administratorit për gabimet e kryera prej tij gjatë ushtrimit të detyrës.

KREU IV
Viti financiar-ekspertet

Neni 16

Viti Financiar

16. Viti financiar i Shoqërisë fillon me 1 Janar dhe perfundon me 31 Dhjetor. Perjashtimisht, viti i parë financiar fillon nga data e regjistrimit të shoqërisë në Qendrën Kombëtare të Regjistrimit dhe mbyllet me 31 Dhjetor.

Neni 17

Ekspertet

17.1 Eksperti ka për detyrë që të kontrollojë të gjithë dokumentacionin kontabel të veprimtarisë ekonomiko tregtarë të shoqërisë, atë gjithëvjetor dhe atë në lidhje me kontrollet periodike të ushtruara prej tij për rastet kur ai është ngarkuar dhe ka kryer një gjë të tilla i ngarkuar nga ana e ortakëve.

17.2 Në përfundim të kontrollit eksperti kontabël i autorizuar përgatit raportin me shkrim për nxjerrjen e rezultatit të bilancit financiar vjetor si dhe për atë për kontrollet periodike të ushtruara, të cilat është i detyruar që t'ja paraqesë e dorëzojë në kohë ortakëve për t'i shqyrtuar e miratuar mbi bazën e të drejtës vendimore që ka.

Kreu V

Prishja –riorganizimi i shoqërisë

Neni 18

Prishja dhe likuidimi

18.1 Shpërndarja ose prishja e shoqërisë mund të behet në çdo kohë :

- a) kur mbaron kohëzgjatja e parashikuar në themelimin e saj;
- b) me vendim të Asamblese së Ortakëve;
- c) me hapjen e procedurave të falimentimit;

ç) nëse nuk ka kryer veprimtari tregtare për dy vjet dhe nuk është njoftuar pezullimi i veprimtarisë në përputhje me pikën 3 të nenit 43 të ligjit nr.9723, datë 3.5.2007 “Për Qendrën Kombëtare të Biznesit”;

d) me vendim të gjykatës;

18.2 Në këtë rast Ortaket merrin vendim me shkrim në të cilin parashikojnë mënyrën e likuidimit të shoqërisë, duke caktuar 1 apo disa likuidatorë dhe shënuar në cdo dokument të nxjerre prej tij emrin e likuidatorit dhe emertesën shtesë “ Shoqëri ne likuidim e sipër “.

18.3 Prishja e shoqërive tregtare ka si pasojë hapjen e procedurave të likuidimit në gjendjen e aftësisë pagueese, me përjashtim të rasteve kur është nisur një procedurë falimentimi.

18.4 Likuidimi kryhet nga likuiduesit e emëruar nga Ortaket me vendim asambleje

18.5 Nëse Ortaket nuk merrin një vendim për emërimin e likuiduesve, brenda 30 ditëve pas prishjes, çdo person i interesuar mund t'i drejtohet gjykatës, për të caktuar një likuidues.

Neni 19

Riorganizmi i shoqërisë bashkimi-ndarja

19.1 Shoqëria mund të ndahet, bashkohet sipas Vedimit të Mbledhjes së Përgjithshme të Asamblesë së Ortakëve, në përputhje me dispozitat ligjore të parashikuara në Pjesën IX të Ligjit 9901 datë 14.04.2012 “Për tregtarët dhe shoqëritë tregtare.”

Neni 20

Baza Ligjore

20.1 Shoqëria do të zhvillojë aktivitetin e tij në përputhje të plotë me këtë statut dhe dispozitat e legjislacionit shqiptar.

20.2 Per sa nuk parashikohet në këtë statut, do te zbatohen dispozitat e ligjit “Për tregtarët dhe shoqëritë tregtare”, Kodit Civil dhe çfaredo ligji tjeter specifik në Republikën e Shqipërisë.

Neni 21

Mosmarrëveshjet

21.1 Për mosmarrëveshjet që mund të lindin në lidhje me zbatimin apo interpretimin e këtij statuti, si dhe për çdo mosmarrëveshje që mund të lindë midis Shoqërisë dhe të tretëve, do të jetë kompetente Gjykata Shqiptare.

ORTAKU
E SHOQËRISE ME PËRGJEGJËSI TË KUFIZUAR
“EUROASIA CLEAN ENERGY”

EUROASIA GROUP SH.P.K

Theodhora Koxhioni

Theodhora Koxhioni



Ortaku I vetem
Ilirjan Koxhioni

Ilirjan Koxhioni